

DEKRET
Nr.7403, datë 31.7.1990

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.4171, DATË 13.9.1966 “PËR SIGURIMET
SHOQËRORE SHTETËRORE TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË” DHE NË LIGJIN NR.4976, DATË 29.6.1972 “PËR PENSIONET E
ANËTARËVE TË KOOPERATIVAVE BUJQËSORE”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshllit të Ministrave

**PRESIDUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore shtetërore të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë“, bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi i katërt i nenit 45 ndryshohet si vijon:

“Komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit, kur e çmon të arsyeshme, gjykon dhe vendos për t’i hequr pensionistit të drejtën që të marrë 100 lekë mbi pensionin, në rast se atij i janë hequr nga gjykata titujt e nderi dhe dekoratat, për krime kundër shtetit”.

- Paragrafi i dytë i nenit 57 dhe nenet 60 e 60/a, shfuqizohen.

- Neni 58 ndryshohet si vijon:

“Pensionet paguhen në masën 50 për qind, gjatë kohës që pensionisti vuan dënimin me heqje të lirisë“.

Neni 2

Në ligjin nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore“, paragrafi i tretë i nenit 24 dhe nenet 25 e 25/a, shfuqizohen, kurse paragrafi i katërt i nenit 24 ndryshohet si vijon:

“Pensionet paguhen në masën 50 për qind, gjatë kohës që pensionisti vuan dënimin me heqje të lirisë“.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PËR PRESIDUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË**

**SEKRETARI
SIHAT TOZAJ**

**KRYETARI
RAMIZ ALIA**